

## Ekonomi

# Rrugët rurale, nis projekti 400 milionë dollarë i BB-së

Oketa: Qeveria do përmirësojë infrastrukturën rurale

Projekti prezantohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Teuta Shamku

Rrugët rurale dhe ato dytësore do të nisnin nga rehabilitimi i tyre brenda vitit 2008. Financimi i projektit të këtyre rrugëve nga banka, që është paralajmëruar kohë më parë nga kryeministri Berisha, ka marrë udhë, duke garantuar një rehabilitim e një pjesë të mirë të rrjetit rrugor rural. Fillimi i zbatimit të projektit të ri që financohet nga Banka Botërore me vlerë 400 milionë USD, për ndërtimin e rrugëve dytësore dhe lokale në Shqipëri, është prezantuar dje nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH). Komponentët kryesorë të këtij projekti do të jenë përmirësimi i seksioneve prioritare të rrjetit dytësor dhe lokal të rrugëve në gjithë Shqipërinë, futja e kontratave të mirëmbajtjes, duke kontraktuar sektorin privat për rrjetin lokal të rrugëve, fuqizimin e organizmave përgjegjës për menaxhimin e rrjetit rrugor lokal, dhe konsolidimin e përgjegjësive institucionale për menaxhimin dhe planifikimin nga sektori i rrugëve sekondare.

Në këtë konferencë mori pjesë zëvendëskryeministri Gazmend Oketa, në cilësinë e kryetarit të bordit të FSHZH-së, drejtori i programit të transportit të Bankës Botërore, Martin Humphreys, si edhe përfaqësues të tjerë të qeverisjes qendrore dhe lokale.

Zbatimi i këtij projekti pritet të ndryshojë ndjeshëm lëvizjen e popullsisë në zonat rurale, duke iu ndërtuar rrugë cilësore. Projekti për rehabilitimin e rrugëve dytësore pritet të zgjasë 5 vjet. Në fund të projektit parashikohet të ngrihet jo vetëm një rrjet dytësor dhe komunal i përmirësuar në mënyrë rrifjësore, por edhe një inventar i rifreskuar i të gjitha rrugëve rajonale. Zëvendëskryeministri Oketa ka vlerësuar mbështetjen e Bankës Botërore për zbatimin e projekteve të tilla, që kanë shumë rëndësi për komunitetin e zonave rurale. "Ky është një projekt



**400** milionë USD është fondi i akorduar nga BB për rrugët rurale

ambicioz i qeverisë shqiptare i mbështetur nga BB dhe që do të realizohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Me anë të këtij projekti, qeveria do të synojë të rrisë përpjekjet konkrete për përmirësimin e infrastrukturës në vend, si edhe për shtimin e aksesit ndaj shërbimeve themelore dhe tregjeve ekonomike, veçanërisht në zonat rurale". Drejtori

Ekzekutiv i Fondit Shqiptar të Zhvillimit, Benet Beci, foli rreth aktivitetit kryesor dhe hapat e ardhshëm fillimin e punës. Objektivi i FSHZH-së është lidhja e kontratave të punimeve civile në periudhën kryesore qershor 2008. I gjithë projekti zbatohet në bashkëpunim të ngushtë me Njësitë e Qeverisjes Vendore

## Bode merr garanci nga BB-ja për mbështetjen e projekteve

Banka Botërore ka dhënë edhe një herë garancinë e saj për mbështetjen që do t'i japë vendit tonë për projektet e përbashkëta. Mbështetja iu bë e ditur ministrit të Financave, Ridvan Bode, në takimimin që ai zhvilloi dje me një delegacion të Bankës Botërore të përbërë nga zonja Orsalia Kalantzopoulou, zonja Jane Armitage dhe përfaqësuesja e përhershme e BB-së në Shqipëri, zonja Camille Naumah. Takimi kishte si qëllim

prezantimin e zonjës Armitage si drejtoreshë e re e Bankës Botërore për Evropën Juglindore, duke zëvendësuar zonjën Orsalia Kalantzopoulou, e cila do të kalojë në një funksion të ri. Fillimisht ministri Bode falënderoi zonjën Orsalia Kalantzopoulou për bashkëpunimin shumë të mirë që ka pasur me të dhe i uroi asaj suksese në detyrën e re. Nga ana tjetër, ministri i Financave siguroi drejtoreshën e re të BB-së për Evropën Juglindore se Ministria e Financave

do të jetë një partner i besueshëm dhe shumë bashkëpunues si der më sot edhe në të ardhmen. Më ministri i njohu zyrtarët e lartë të BB-së me zërat kryesorë të buxhetit duke theksuar se buxheti 2008 është i sigurt në zbatimin e tij, parashikon rezerva të larta që do të mjaftonin për përbalimin e çdo situatë të papritur. Bashkëpunimi i folën për projektet e përbashkëta duke dhënë garanci të dyanshme për realizimin me sukses të tyre.